



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 532/23 Data: 19/04/2023

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31, nenit 7 dhe 15 të Ligjit Nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, si dhe Manualin e Akreditimit (*përditësuar me vendimin Ref.932/22*), Këshilli Shtetëror i Cilësisë i Agjencisë së Kosovës për Akreditim, në mbledhjen e 111-të, të mbajtur më 14.04.2023, mori:

V E N D I M

- I. Nuk akreditohet Kolegji UBT dega në Gjilan në nivel institucional.
- II. Ndalohet regjistrimi i studentëve të rinj në Kolegjin UBT dega në Gjilan për vitin akademik 2023/2024 deri në përfundimin e procesit të ri të akreditimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M I

Kolegji UBT dega në Gjilan ka parashtruar kërkesë me Nr.prot.1880/22, datë 31.10.2023, pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (në tekstin e mëtejme AKA) për akreditim në nivel institucional.

AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegji UBT dega në Gjilan me qëllim të vlerësimit në nivel institucional. Vizita është organizuar me datë 21.02.2023, me ekipin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit me përbërje: Dietmar Paier, Anca Greere dhe Christopher Bohlen.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertëve ndërkombëtarë) ka hartuar raportin e vlerësimit dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka konstatuar se nga njëmbëdhjetë (11) fushat e standardeve të akreditimit, Kolegji UBT dega në Gjilan është vlerësuar se përmbushë:

- Plotësisht, zero (0) standarde;
- Substancialisht, një (1) standard;
- Pjesërisht, nëntë (9) standarde;
- Nuk i plotëson standardet, një (1) standard.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë në mbledhjen e 111 të mbajtur më 14.04.2023 ka shqyrtuar kërkesën e Kolegjit UBT dega në Gjilan dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës si dhe në rekomandimin përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër.

Referuar kësaj që u tha më lartë dhe raportit final nga Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertëve ndërkombëtarë), të dorëzuar me datë 10.03.2023, KShC konstatoj se Kolegji UBT dega në Gjilan ka dështuar të përmbushë 10 nga 11 fushat e standardeve të përcaktuar në Manualin e Akreditimit, duke përfshirë edhe kapitullin 6 dhe 10.

Nga që u tha më lartë, bazuar në dispozitat ligjore dhe kompetencat, KShC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.”

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala mund të parashtroj ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Vendimi ju dërgohet :

- Kolegjit UBT dega në Gjilan;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.




Prof. Asoc. M. Hasrija Nazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë